



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2021

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: “**Flamur Asllani**” p.f. me adresë: Lagjja "Dyli Haxhire", bulevardi "Aqif Pasha", pall. nr. 10/1, kati 1, Elbasan.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti I : “Blerje produkte ushqimore - Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 14 muaj, me fond limit **17,939,826 (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e nëntëmijë e tetëqind e njëzet e gjashtë) **lekë (pa tvsh)**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2021 dhe 2022. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Shumatorja e çmimeve për njësi është: **8,550** (tetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) **lekë pa tvsh**.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: Loti I: REF-01629-07-26-2021

Publikime të mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 30.08.2021]
[Numri 130]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “Flamur Asllani” p.f. me Nipt: L 62602209 S

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **6,609** (gjashtëmijë e gjashtëqind e nëntë) **lekë** (pa tvsh).

2. “PROINFINIT” sh.p.k me Nipt: L92204018G

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **7,646** (shtatëmijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) **lekë** (pa tvsh).

3. “Nelsa” sh.p.k me Nipt: J71601012S

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **6.502** (gjashtëmijë e pesëqind e dy) **lekë** (pa tvsh).

4. “Zdravo” sh.p.k me Nipt : J84003411K

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **16.760.500** (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetëmijë e pesëqind) **lekë** (pa tvsh).

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. “Nelsa” sh.p.k me Nipt: J71601012S skualifikohet për arsyet e mër arsyet e mëposhtme:

Ne permbushje te kritereve te vecanta te kualifikimit, te kapacitetit teknik : pika **2.3.4**. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira ambjent të përshtatshëm me sipërfaqe minimumi 30 m2 për prodhimin ose magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- **Aktin e pronësisë ose Kontratën e marrjes me qira të objektit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale.
- **Lejen higjieno-sanitare të objektit të vlefshme** të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë në rrethet përkatëse (Inspektoriat që mbulon fushën e shëndetit).
- Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponimin dhe adresën e saktë të ambjentit. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambjentit.**

Operatori ekonomik ne permbushje te ketij kriteri ka ngarkuar ne SPE dokumentacionin e kerkuar ne DST ne lidhje me disponimin e ambjenteve te pershtatshme per magazinimin e mallrave.

Gjithashtu, operatori ka ngarkuar ne SPE nje deklarate, ne te cilen deklarone se ambjentet qe shoqeria e tyre disponon ndodhen ne adresen "Lagja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona Kadastrale 2460, me nr. pasurie 199/32, Hyrja 1, Dajt, Tirane, por nuk ka deklaruar se cili ambjent do te sherbeje per magazinimin e produkteve ushqimore, te fruta- perimeve, te bulmetit, te produkteve me origjine shtazore si dhe te bukes.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

2. "Zdravo" sh.p.k me Nipt : J84003411K skualifikohet për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik,ka ofertuar me cmim total dhe jo shumatoren te cmimeve per njesi , bazuar në Udhëzimin e APP-së nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7.3, ndryshuar me Udhëzimin e APP-së nr.15 datë 26.11.2018, **ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi.**

Per kete arsye oferta ekonomike konsiderohet e pavlefshme.

2. Ne permbushje te kriterëve te vecanta te kualifikimit, pikat 2.3.5 , operatori ekonomik, ne Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit, nuk ka përcaktuar sakte te dhenat (targen) per mjetin ATP qe disponon.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. "Flamur Asllani" p.f. me Nipt: L 62602209 S

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **6,609** (gjashtëmijë e gjashtëqind e nëntë) **lekë** (pa tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, brenda **10 (dhjetë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Ka pasur ankesë nga operatori ekonomik "Nelsa" sh.pk. Me vendimin nr.3506/22 datë 13.09.2021 autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan vendosi të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Nelsa" sh.pk.

Pas shqyrtimit të ankesës Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.711/2021 datë 04.10.2021 vendosi të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Nelsa" sh.pk.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Irland Sina**